



67 OFICERË TË RINJ NË SHËRBIM TË SHQIPËRISË Akademia e Forcave të Armatosura diplomon brezin më të ri të liderëve ushtarakë

» faqe 4



MINISTRI NUFI: SHQIPËRIA DREJT NJË FAZE TË RE TË SIGURISË DHE MODERNIZIMIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA

Investimet në mbrojtje, Samiti i NATO-s në Tiranë dhe forcimi i kapaciteteve kombëtare, në fokus të konferencës për media. Ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nufi, zhvilloi një konferencë për media, ku prezantoi prioritetet strategjike të Ministrisë së Mbrojtjes, zhvillimet në kuadër të Aleancës së Atlantikut të Veriut, investimet në fushën e mbrojtjes, si dhe masat e ndërmarra...

faqe 3



STAFETA E NDERIT: NGJA DORA E BABAIT, NË MISIONIN PËR ATDHEUN

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Një përqafim, një diplomë, një betim. Ka fotografi që dokumentojnë një ngjarje dhe ka fotografi që rrëfejnë një epokë. Në ceremoninë e diplomimit të oficerëve të rinj në Akademinë e Forcave të Armatosura u fiksua një prej atyre imazheve që mbeten gjatë në kujtesë. Një baba, me gradën më të lartë ushtarake në vend...

faqe 6



LUFTA NUK KA FITUES PAQJA NUK ËSHTË DOBËSI, ËSHTË FORCA MË E MADHE E QYTETËRIMIT

"Një komb që harron historinë e luftërave të tij, rrezikon të mos njohë vlerën e paqes". Nga iluzioni i paqes drejt realitetit të ri të sigurisë. Për më shumë se tri dekada pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, Evropa jetoi me bindjen se konfliktet e mëdha ushtarake i përkisnin së shkuarës. Rënia e Murit të Berlinit, shpërbërja e blloqeve...

faqe 11

Forca Ajrore shqiptare në Konferencën Botërore të Komandantëve të Forcave Ajrore në Londër

Gjeneral brigade Edmond Voci diskuton sfidat e reja të domenit ajror dhe forcimin e bashkëpunimit me aleatët

Komandanti i Forcës Ajrore të Republikës së Shqipërisë, gjeneral brigade Edmond Voci, mori pjesë në Konferencën Botërore të Komandantëve të Forcave Ajrore (Global Air & Space Chiefs' Conference), zhvilluar në Londër. Kjo konferencë përbën një nga platformat më të rëndësishme ndërkombëtare për drejtuesit e Forcave Ajrore aleate dhe partnere, duke ofruar mundësi për shkëmbimin e përvojave, diskutimin e sfidave të përbashkëta të sigurisë dhe forcimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes ajrore. Gjatë zhvillimeve të konferencës u trajtuan çështje me rëndësi strategjike për të ardhmen e fuqisë ajrore dhe hapësinore, përfshirë zhvillimet teknologjike, përshtatjen e kapaciteteve ndaj sfidave të reja dhe rritjen e ndërveprimit ndërmjet Forcave Ajrore të vendeve aleate dhe partnere. Pjesëmarrja e drejtuesit të Forcës Ajrore shqiptare në këtë aktivitet ndërkombëtar përbën një mundësi të rëndësishme për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me partnerët strategjikë, si dhe për shkëmbimin e eksperiencave në funksion të zhvillimit të kapaciteteve ajrore të Forcave të Armatosura.



Në kuadër të vizitës në Mbretërinë e Bashkuar, **gjeneral brigade Edmond Voci** ndoqi gjithashtu aktivitetin prestigjioz **“Royal International Air Tattoo 2026”**, të zhvilluar në bazën ajrore **RAF Fairford**.

Ky aktivitet, një nga shfaqjet më të mëdha ajrore në botë, bashkon çdo vit Forca Ajrore nga vende të ndryshme, duke shërbyer si një mundësi për prezantimin e kapaciteteve,



teknologjive të reja dhe forcimin e lidhjeve mes komunitetit ndërkombëtar të aviacionit ushtarak. Pjesëmarrja në këto aktivitete ndërkombëtare dëshmon angazhimin e Forcës Ajrore të Republikës së Shqipërisë për të qenë pjesë aktive e dialogut profesional me aleatët dhe për të vijuar zhvillimin e saj në përputhje me standardet e NATO-s.



Forca Detare përfundon me sukses misionin trevjeçar në kuadër të NATO-s

Përmbillet një kapitull i rëndësishëm i kontributit shqiptar në operacionet e Aleancës

Pas tre vitesh angazhimi të pandërprerë, Forca Detare e Republikës së Shqipërisë ka përmbyllur me sukses një mision të rëndësishëm në kuadër të NATO-s, duke dëshmuar edhe një herë profesionalizmin, përkushtimin dhe përgjegjshmërinë e personelit të saj në përmbylljen e detyrave operacionale.

Gjatë kësaj periudhe, efektivet e Forcës Detare përfaqësuan me dinjitet Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë në një mjedis shumëkombësh me rëndësi strategjike, duke kontribuar në forcimin e sigurisë kolektive, ndërveprimit me aleatët dhe realizimin e objektivave të Aleancës.

Ky angazhim përbën një tjetër dëshmi të rolit aktiv të Shqipërisë në strukturat e NATO-s dhe të aftësisë së Forcës Detare për të operuar sipas standardeve më të larta profesionale, në bashkëpunim me vendet aleate dhe partnere.

Përvoja e fituar gjatë këtij misioni do të shërbejë në rritjen e mëtejshme të kapaciteteve operacionale të Forcës Detare, duke forcuar gatishmërinë dhe ndërveprimin në misionet shumëkombëshe.

Forca Detare e Republikës së Shqipërisë mbetet e angazhuar për të vijuar kontributin e saj në operacionet dhe misionet e NATO-s dhe të Bashkimit Evropian, duke dhënë një rol aktiv në mbështetje të paqes, sigurisë dhe stabilitetit ndërkombëtar, në përputhje me angazhimet e vendit tonë si aleat i besueshëm.



Kontingjenti XIX EOD kontribuon në stërvitjen shumëkombëshe “Sapper Forge” në Letoni

Efektivët shqiptarë garantojnë sigurinë e operacioneve në kuadër të misionit të NATO-s

Efektivët e Kontingjentit XIX EOD të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të angazhuar në kuadër të misionit të Forcës së Përparuar Tokësore të NATO-s (Forward Land Forces) në Letoni, vijnë në përmbyllje me profesionalizëm detyrat e tyre në mbështetje të stërvitjeve të Brigadës Shumëkombëshe.

Në kuadër të stërvitjes fushore “Sapper Forge”, specialistët shqiptarë të asgjësimit të mjeteve shpërthyes (EOD) realizuan me sukses zbulimin dhe pastrimin e rrugëkalimeve nga mjetet shpërthyes të improvizuara (IED) dhe municionet e pashpërthyer (UXO), duke garantuar lëvizjen e sigurt të forcave dhe zhvillimin normal të operacioneve stërvitore.

Angazhimi i Kontingjentit XIX EOD përbën një kontribut të rëndësishëm në rritjen e sigurisë së forcave pjesëmarrëse dhe në suksesin e stërvitjes shumëkombëshe, duke dëshmuar nivelin e lartë profesional të efektiveve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.



Pjesëmarrja në misionet dhe stërvitjet e NATO-s forcon më tej ndërveprueshmërinë me forcat aleate, shkëmbimin e përvojave dhe aftësitë operacionale të personelit shqiptar, në përputhje me standardet e Aleancës.

Me përkushtim, disiplinë dhe profesionalizëm, efektivet e Kontingjentit XIX EOD vijnë në përfundim të misionit të tyre në Letoni, duke dhënë një kontribut të çmuar në forcimin e sigurisë kolektive dhe të bashkëpunimit me aleatët e NATO-s.



Ministri Nufi: Shqipëria drejt një faze të re të sigurisë dhe modernizimit të Forcave të Armatosura

Investimet në mbrojtje, Samiti i NATO-s në Tiranë dhe forcimi i kapaciteteve kombëtare, në fokus të konferencës për media

Ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nufi, zhvilloi një konferencë për media, ku prezantoi prioritetet strategjike të Ministrisë së Mbrojtjes, zhvillimet në kuadër të Aleancës së Atlantikut të Veriut, investimet në fushën e mbrojtjes, si dhe masat e ndërmarra për përballimin e situatës së zjarreve në vend.

Në fjalën e tij, ministri Nufi u ndal te vendimi për organizimin e Samitit të ardhshëm të NATO-s në Tiranë, duke e cilësuar atë një vlerësim të rëndësishë strategjike të Shqipërisë dhe të rolit të saj në rritje brenda Aleancës.

Sipas ministrit, NATO po hyn në një etapë të re zhvillimi, të konceptuar si **“NATO 3.0”**, ku sfidat e reja të sigurisë kërkojnë rritje të kapaciteteve mbrojtëse, investime të qëndrueshme dhe një angazhim më të madh nga vendet aleate.

“Shqipëria po përgatitet për këtë realitet të ri përmes forcimit të kapaciteteve të saj mbrojtëse dhe investimeve strategjike në sektorin e sigurisë”, - u shpreh ministri Nufi.

Rritje e investimeve në mbrojtje dhe modernizim i Forcave të Armatosura

Gjatë konferencës, ministri Nufi bëri të ditur se Shqipëria ka hyrë në një trajektore të qëndrueshme të rritjes së investimeve në mbrojtje, duke arritur nivelin prej 2.6% të Prodhimit të Brendshëm Bruto të alokuar **për buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes**.

Ai theksoi se këto investime nuk përfaqësojnë vetëm përmbushje të angazhimeve ndaj NATO-s, por janë një investim i drejtpërdrejtë në sigurinë kombëtare, stabilitetin e vendit dhe rritjen e aftësive operacionale **të Forcave të Armatosura**.

Ministri Nufi nënvizoi se modernizimi i Forcave të Armatosura mbetet prioriteti kryesor i Ministrisë së Mbrojtjes, me fokus në zhvillimin e kapaciteteve të reja, pajisjen moderne dhe rritjen e ndërveprimit me strukturat aleate.

Në këtë kuadër, ai veçoi marrëveshjen me kompaninë FINCANTIERI, e cila pritet të sjellë zhvillime të rëndësishme në sektorin e mbrojtjes dhe të gjenerojë rreth 500 vende pune në Pashaliman.

Një tjetër projekt strategjik i përmendur ishte hapja e Shkollës Kombëtare të Fluturimit, e cila përbën një hap të rëndësishëm në modernizimin e Forcës Ajrore dhe në krijimin e kapaciteteve të reja profesionale për personelin fluturues të Forcave të Armatosura.

Shqipëria, aleate aktive dhe kontribuuese në NATO

Ministri Nufi ritheksoi se Shqipëria do të vijojë të jetë një kontribuuese aktive në misionet dhe operacionet ndërkombëtare të NATO-s dhe partnerëve strategjikë.



Sipas tij, angazhimi i vazhdueshëm i Forcave të Armatosura në operacionet ndërkombëtare është një dëshmi e profesionalizmit të personelit ushtarak shqiptar dhe e rolit të vendit tonë si një aleate e besueshme në mbështetje të sigurisë dhe paqes.

Koordinim i kapaciteteve për përballimin e zjarreve

Duke u ndalur te situata e zjarreve në vend, ministri Nufi bëri të ditur se Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) ka administruar në kohë reale informacionet e ardhura nga strukturat vendore dhe ka koordinuar aktivizimin e kapaciteteve shtesë tokësore dhe ajrore për përballimin e emergjencave.

Ai vlerësoi përdorimin e teknologjive moderne në monitorimin dhe menaxhimin e situatave të rrezikut, duke theksuar se dronët **“Bayraktar”** kanë rezultuar një mjet efikas për evidentimin e hershëm të vatrave të zjarrit dhe për koordinimin më të mirë të ndërhyrjeve në terren.

Në përfundim të konferencës, ministri i Mbrojtjes shprehu mirënjohjen për të gjithë efektivistët e Forcave të Armatosura, zjarrfikësit, strukturat e mbrojtjes civile dhe çdo person të angazhuar në përballimin e emergjencave nga zjarret. Ai u bëri thirrje qytetarëve të tregojnë përgjegjësi maksimale dhe të shmangin ndezjen e zjarreve në ambiente të hapura, në toka bujqësore, pranë pyjeve, kullotave dhe zonave me bimësi, për të parandaluar përhapjen e flakëve dhe rrezikimin e jetës, pronës dhe mjedisit.



Efektivët e Forcës Tokësore do të kontribuojnë në misionin e Bashkimit Evropian, EUFOR ALTHEA

Në Regjimentin e Këmbësisë së Jugut (RKJ), në Poshnjë të Beratit, u zhvillua ceremonia e përcjelljes së Kontingjentit shqiptar **“ALTHEA-4”**, i cili do të dislokohej në Bosnje dhe Hercegovinë në kuadër të pjesëmarrjes së Republikës së Shqipërisë në misionin ndërkombëtar **EUFOR ALTHEA**.

Kontingjenti, i përbërë nga efektivë të Forcës Tokësore, ka përfunduar me sukses përgatitjen operacionale dhe është certifikuar sipas standardeve të NATO-s, duke qenë i gatshëm të përmbushë detyrat e tij në mbështetje të sigurisë, stabilitetit dhe paqes në Bosnje dhe Hercegovinë.

Pjesëmarrja në misionin **EUFOR ALTHEA** dëshmon angazhimin e vazhdueshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionet ndërkombëtare, si dhe kontributin e tyre aktiv në ruajtjen e paqes dhe sigurisë rajonale, në bashkëpunim me aleatët dhe partnerët ndërkombëtarë.

Dislokimi i Kontingjentit **“ALTHEA-4”** riafirmon profesionalizmin dhe gatishmërinë e Forcës Tokësore

Kontingjenti shqiptar “ALTHEA-4” niset drejt Bosnje dhe Hercegovinës



për të marrë pjesë në misione shumëkombëshe, duke përmbushur me përgjegjësi angazhimet e Shqipërisë në kuadër të politikës së përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes së Bashkimit Evropian.

Në përfundim të ceremonisë, efektivët e kontingjentit morën urimet për sukses në përmbushjen e misionit, duke u vlerësuar për përkushtimin, disiplinën dhe gatishmërinë për të përfaqësuar me dinjitet Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë në një tjetër mision ndërkombëtar.



67 OFICERË TË RINJ NË SHËRBIM TË SHQIPËRISË

Akademia e Forcave të Armatosura

diplomon brezin më të ri të liderëve ushtarakë

Garnizoni “Skënderbej” u shndërrua në qendrën e një prej ceremonive më të rëndësishme të Forcave të Armatosura, **ku 67 oficerë të rinj**, mes tyre **10 nga Republika e Kosovës**, morën gradën e parë të oficerit në ceremoninë solemne të diplomimit të organizuar nga Akademia e Forcave të Armatosura. Tashmë ata janë pjesë e brezit të ri të drejtuesve ushtarakë, të përgatitur për të shërbyer në një mjedis sigurie gjithnjë e më kompleks dhe në një ushtri tërësisht të orientuar drejt standardeve të NATO-s.

Ceremonia solemne shënoi kurorëzimin e një etape të rëndësishme në formimin e brezit më të ri të oficerëve shqiptarë dhe të Republikës së Kosovës, duke përcjellë një mesazh të qartë për forcimin e lidërshipt ushtarak, modernizimin e Forcave të Armatosura dhe besimin tek të rinjtë që do të mbajnë mbi supe sigurinë e vendit.

Nuk ishte thjesht një ceremoni diplomimi. Ishte një ditë krenarie për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për Akademinë e Forcave të Armatosura dhe për dhjetëra familje që panë fëmijët e tyre të merrnin gradën e parë të oficerit, duke hyrë zyrtarisht në radhët e ushtrisë shqiptare.

Në ceremoni morën pjesë kryeministri Edi Rama, ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Ferdinand Dimo, drejtues të lartë ushtarakë, përfaqësues të institucioneve shtetërore, atashe ushtarakë të vendeve aleate, pedagogë, familjarë dhe të ftuar.

Atmosfera ishte e mbushur me emocion. Uniformat ceremoniale, rreshtimi i oficerëve të rinj, prania e familjeve dhe momenti i marrjes së diplomave krijuan një tablo që simbolizonte vazhdimësinë e traditës ushtarakë shqiptare dhe përgatitjen e brezit që do të udhëheqë Forcat e Armatosura në vitet e ardhshme.

Akademia ku formohen liderët e së nesërme

Në fjalën e tij përshëndetëse, Komandanti i Akademisë

së Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Ferdinand Dimo, e cilësoi diplomimin si një moment kulmor në jetën profesionale të kursantëve dhe një sukses për institucionin që ka mision përgatitjen e elitës ushtarake të vendit.

Ai vlerësoi punën, disiplinën dhe përkushtimin e oficerëve të rinj gjatë gjithë periudhës së formimit, duke theksuar se diploma që merrnin në atë ceremoni ishte rezultat i një rrugë të ndërtuar mbi sakrificën, përgatitjen akademike dhe edukimin me vlerat më të mira ushtarake.

Gjeneralmajor Dimo nënvizoi se Akademia po kalon një proces të rëndësishëm modernizimi, duke përshtatur programet e saj me standardet më bashkëkohore të arsimit ushtarak të NATO-s. Sipas tij, sot nuk mjafton vetëm përgatitja teorike, por kërkohen drejtues me karakter, integritet, aftësi vendimmarrëse dhe vizion strategjik.

Duke iu drejtuar oficerëve të rinj, ai theksoi se grada e parë nuk është fundi i një rrugëtimi, por fillimi i një përgjegjësie shumë më të madhe ndaj ushtarëve që do të drejtojnë, ndaj institucionit dhe ndaj Republikës së Shqipërisë.

Lidërshipti ushtarak përballë sfidave të reja

Një mesazh të rëndësishëm përcolli edhe i Shtabit të

Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji.

Ai theksoi se oficerët e rinj do të shërbejnë në një periudhë kur mjedisi i sigurisë ndërkombëtare po ndryshon me shpejtësi dhe kur kërcënimet kërkojnë përgatitje profesionale, fleksibilitet dhe bashkëpunim të ngushtë me aleatët.

Gjenerallejtënant Kingji u ndal te rëndësia e lidërshipt ushtarak, duke nënvizuar se komandanti duhet të jetë shembull profesionalizmi, discipline dhe integriteti. Ai i ftoi oficerët e sapo diplomuar ta konsiderojnë uniformën jo si privilegj, por si një përgjegjësi të përhershme ndaj vendit dhe qytetarëve.

Në mesazhin e tij ai vlerësoi gjithashtu rolin e Akademisë në formimin e brezit të ri të drejtuesve ushtarakë dhe shprehu besimin se oficerët e rinj do të kontribuojnë në rritjen e kapaciteteve operacionale të Forcave të Armatosura.

Zëri i brezit të ri

Një nga momentet më emocionuese të ceremonisë ishte fjala e dy oficerëve të sapo diplomuar, të cilët folën në emër të të gjithë kursit.



Ata shprehën mirënjohjen për komandën e Akademisë, pedagogët dhe instruktorët që i shoqëruan gjatë gjithë procesit të formimit, si dhe falënderuan familjet për mbështetjen e vazhdueshme.

Në emër të të gjithë të diplomuarve, ata u zotuan se do ta mbajnë me dinjitet uniformën e oficerit shqiptar, duke shërbyer me besnikëri, ndershmëri dhe profesionalizëm, kudo që do t'i kërkojë detyra.

Mesazhi i tyre u prit me duartrokitje të gjata, pasi pasqyroi emocionin, krenarinë dhe ndjenjën e përgjegjësisë që shoqëron fillimin e karrierës ushtarake.



Investimi tek njeriu mbetet prioritet

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, e cilësoi ceremoninë si një moment të rëndësishëm për të gjithë sistemin e mbrojtjes.

Ai theksoi se Akademia është institucioni ku ndërtohet lidershipi i ardhshëm ushtarak dhe se investimi në arsimimin ushtarak është një investim i drejtpërdrejtë në sigurinë kombëtare.

Ministri përgëzoi oficerët e rinj për përfundimin me sukses të kursit, duke nënvizuar se ata do të jenë pjesë e transformimit të mëtejshëm të Forcave të Armatosura dhe e rritjes së ndërveprueshmërisë me vendet aleate.

Transformimi i Forcave të Armatosura

Në fjalën e tij, Kryeministri Edi Rama e vendosi ceremoninë



në kontekstin e transformimit që kanë përjetuar Forcat e Armatosura gjatë viteve të fundit.

Ai kujtoi se ushtria shqiptare ka kaluar nga një periudhë me mungesa të mëdha infrastrukturore dhe financiare në një forcë moderne, me investime në pajisje, baza ushtarake, arsimim dhe personel.

Kryeministri theksoi se sot ushtarakët shqiptarë janë më të mirë paguarit në rajon dhe ritheksoi objektivin që deri në vitin 2030 pagat e tyre të arrijnë mesataren e vendeve të NATO-s. Ai bëri të ditur gjithashtu se po punohet për përmirësimin e mëtejshëm të statusit të ushtarakut, si një tjetër hap në



mbështetje të personelit të Forcave të Armatosura.

Duke iu drejtuar të diplomuarve, Rama theksoi se zgjedhja për të veshur uniformën është zgjedhje për t'i shërbyer vendit, duke i ftuar të ushtrojnë detyrën me profesionalizëm, ndershmëri dhe përkushtim.

Një moment që shënon të ardhmen

Pjesa më solemne e ceremonisë ishte dorëzimi i diplomave dhe vendosja e gradës së parë të oficerit.

Emocionet e oficerëve të rinj u ndërthurën me krenarinë e familjeve, ndërsa betimi ushtarak vulosi zyrtarisht hyrjen e tyre në radhët e Forcave të Armatosura.

Diplomimi i 67 oficerëve të rinj, mes tyre edhe 10 nga Republika e Kosovës, është shumë më tepër sesa përfundimi i një kursi. Ai përfaqëson vazhdimësinë e traditës së arsimit ushtarak shqiptar, forcimin e bashkëpunimit me Kosovën dhe investimin afatgjatë në lidërshpin që do të drejtojë ushtrinë shqiptare në dekadat që vijnë.

Akademia e Forcave të Armatosura konfirmoi edhe një herë rolin e saj si institucioni ku formohen profesionistët e mbrojtjes dhe ku ndërtohet brezi i ri i komandantëve, të gatshëm për t'i shërbyer Shqipërisë dhe Aleancës së Atlantikut të Veriut me përgjegjësi, dinjitet dhe përkushtim.



STAFETA E NDERIT: Nga dora e babait, në misionin për Atdheun



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Një përqafim, një diplomë, një betim

Ka fotografi që dokumentojnë një ngjarje dhe ka fotografi që rrëfejnë një epokë. Në ceremoninë e diplomimit të oficerëve të rinj në Akademinë e Forcave të Armatosura u fiksua një prej atyre imazheve që mbeten gjatë në kujtesë. Një baba, me gradën më të lartë ushtarake në vend, i dorëzonte diplomën djalit të tij. Nuk ishte thjesht një emocion familjar. *Ishte simboli i një trashëgimie që nuk matet me gradat, por me vlerat, përgjegjësinë dhe betimin që kalojnë brez pas brezi.*

Një moment i tillë u përjetua në ceremoninë e diplomimit të 67 oficerëve të rinj në Akademinë e Forcave të Armatosura, zhvilluar në Garnizonin “Skënderbej”. Mes diplomave që u dorëzuan, njëra prej tyre kishte një domethënie të veçantë. Ishte diploma që **shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, ia dorëzoi djalit të tij**, tashmë oficer i ri i Ushtrisë Shqiptare.

Në pamje të parë ishte një moment familjar. Në të vërtetë ishte shumë më tepër.

Nuk ishte thjesht një baba që përgëzonte të birin për një arritje të rëndësishme. Ishte ushtaraku më i lartë i vendit që, me dorën e tij, i dorëzonte brezit të ri simbolin e një përgjegjësie që ai vetë e ka mbajtur për dekada. Ishte një akt që tejkalonte lidhjen e gjakut dhe fitonte një kuptim institucional.

Në atë çast dukej sikur dy breza takoheshin në të njëjtën uniformë. Njëri me përvojën e gjatë të shërbimit, me misione, vendimmarrje dhe përgjegjësi të mëdha.

Tjetri në fillim të rrugës, me ëndrra, idealizëm dhe dëshirën për t'i shërbyer atdheut.

Ky nuk ishte vetëm një emocion personal për familjen Kingji. Ishte një emocion që u nda nga të gjithë të pranishmit.

Në sytë e shumë ushtarakëve të pranishëm, ai moment nuk përfaqësonte vetëm suksesin e një të riu. Ai mishëronte vazhdimësinë e institucionit. Aty ku përfundon misioni i një brezi, nis përgjegjësia e brezit tjetër.

Kur uniforma bashkon dy breza

Në ushtri kjo ka një peshë të veçantë. Sepse uniforma nuk trashëgohet si një privilegj. Ajo fitohet. Fitohet me përkushtim, me disiplinë, me sakrificë dhe me besimin që institucioni vendos tek secili oficer.

Prandaj edhe momenti kur një gjeneral i dorëzon gradën apo diplomën djalit të tij nuk është simbol i një privilegji familjar.

Përkundrazi.



Është dëshmia se edhe djali i Komandantit të Ushtrisë duhet të kalojë të njëjtën rrugë si çdo kadet tjetër, të përballët me të njëjtat kërkesa, të kalojë të njëjtat provime dhe të fitojë me meritë të drejtën për të mbajtur yllin e parë të oficerit.

Kjo është forca e institucioneve.

Kjo është forca e Akademisë së Forcave të Armatosura.

Aty ku vazhdon misioni

Në historinë e ushtrive moderne, nuk kanë munguar rastet kur breza të tërë kanë zgjedhur të ndjekin të njëjtën rrugë të shërbimit ushtarak.

Familje ku baballarët, bijtë, madje edhe nipërit kanë mbajtur të njëjtën uniformë, jo sepse e imponon tradita, por sepse e frymëzon shembulli. Edhe në Shqipëri ka pasur dhe vazhdon të ketë familje të tilla. Familje që e kanë lidhur jetën me Forcat e Armatosura dhe që e shohin shërbimin ndaj atdheut si një mision që kalon nga një brez tek tjetri.

Ceremonia e diplomimit solli pikërisht këtë mesazh.

Modernizimi i Forcave të Armatosura nuk matet vetëm me investimet në teknologji, pajisje apo infrastrukturë.

Ai matet mbi të gjitha me njerëzit.

Me brezat që vijnë.

Me cilësinë e oficerëve të rinj.

Me kulturën profesionale që trashëgohet.

Me vlerat që nuk ndryshojnë, edhe kur ndryshojnë kohët.

ATJE KU FILLON MISIONI

Disiplina.

Nderi.

Besnikëria.

Përgjegjësia.

Shërbimi.

Janë këto shtyllat mbi të cilat ndërtohet çdo ushtri moderne. Dhe janë pikërisht këto vlera që u panë të mishëruara në atë çast të heshtur, kur një baba i dorëzoi diplomën djalit të tij. Ndoshta për disa ishte vetëm një fotografi.

Për ushtarakët ishte shumë më tepër. Ishte fotografia e vazhdimësisë.

Fotografia e besimit. Fotografia e një ushtrie që ndërton të ardhmen mbi përvojën e brezave.

Një yll më shumë për Shqipërinë

Në një kohë kur sfidat e sigurisë janë bërë më komplekse se kurrë, Forcat e Armatosura kanë nevojë për oficerë të përgatitur profesionalisht, por edhe për njerëz që e kuptojnë se uniforma nuk është vetëm një veshje.

Ajo është një betim.

Një mënyrë jetese.

Një përgjegjësi që të shoqëron çdo ditë.

Momenti i përqaimit mes **gjenerallejtënant Arben Kingjit dhe djalit të tij** do të mbetet një nga imazhet më domethënëse të kësaj ceremonie.

Jo për protagonizëm, por sepse ai përfaqësoi diçka që shkon përtej një familjeje. **Përfaqëson** vazhdimësinë e misionit ushtarak.

Besimin se Shqipëria do të ketë gjithmonë vajza dhe djem që do të zgjedhin me ndërgjegje të veshin uniformën dhe t'i shërbejnë flamurit.

Ushtria nuk ndërtohet vetëm me armë e pajisje moderne. Ajo ndërtohet me njerëz. Me karakter. Me shembuj. Dhe me breza që i japin dorën njëritjetrit, duke e mbajtur të gjallë betimin për Atdheun.



FARKËTIMI I OPERATORËVE TË ZBULIMIT



NEXHBEDIN BASHA
Major në Rezervë

Përfundon Kursi i Parë Bazë i Zbulimit në Regjimentin e Operacioneve Speciale: 38 kursantë certifikohen pas një prove të vërtetë fizike dhe profesionale

Nga terreni i vështirë të standardet e NATO-s, një brez i ri operatorësh zbulimi përgatitet për misionet e së ardhmes

Nën hijen e pyjeve, mbi kodrat e thata të korrikut dhe në shtigjet ku çdo hap ngrihej me pluhur, Regjimenti i Operacioneve Speciale i Forcave të Armatosura u kthye në një arenë prove për qëndrueshmërinë, disiplinën dhe karakterin ushtarak.

Aty ku përgatiten beretat blu, beretat vishnje, trupat komando, forcat speciale dhe strukturat e zbulimit, çdo ditë stërvitjeje është më shumë se një proces mësimi. Është një sfidë që kërkon përkushtim maksimal dhe gatishmëri për të përballuar çdo situatë operacionale.

Në këtë mjedis u zhvillua për herë të parë Kursi Bazë i Zbulimit, një iniciativë e re dhe e rëndësishme për rritjen e kapaciteteve profesionale të strukturave të zbulimit të Forcave të Armatosura.

Nisma për ngritjen e këtij kursi u ndërmor nga komandanti i Regjimentit të Operacioneve Speciale, kolonel Ajet Jata, i cili, në bashkëpunim me Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, mundësoi konceptimin, organizimin dhe mbështetjen profesionale e logjistike të këtij programi.

Ky kurs përfaqëson një hap të rëndësishëm në përgatitjen e operatorëve të zbulimit sipas standardeve bashkëkohore të Aleancës së Atlantikut të Veriut dhe përvojës së strukturave partnere të NATO-s.

Një përzgjedhje për më të mirët

Në Kursin e Parë Bazë të Zbulimit morën pjesë 53 ushtarë, nënoficerë dhe oficerë të Kompanisë së Zbulimit. Programi intensiv ishte ndërtuar për të testuar jo vetëm njohuritë profesionale, por edhe aftësinë fizike, qëndrueshmërinë psikologjike dhe vendosmërinë e çdo pjesëmarrësi. Në përfundim të gjithë fazave të trajnimit, u certifikuan 39 kursantë, të cilët arritën të përballojnë me sukses kërkesat e larta të këtij cikli të specializuar.

Në drejtimin e kursit ishte kapiten Enri Gjergji, komandant i Kompanisë së Zbulimit dhe komandant i Kursit Bazë të Zbulimit. Nën drejtimin e tij, përgatitja teorike u ndërthur ngushtë me praktikën operacionale, duke e kthyer çdo ditë trajnimi në një provë reale të aftësive të kursantëve.

Kur terreni bëhet mësuesi më i mirë

Marshime 24-orëshe me distanca mbi 60 kilometra, stërvitje 72-orëshe me më shumë se 180 kilometra lëvizje në terrene të thyera, katër ditë mbijetese, orientim ditën dhe natën, patrullime, fushime dhe skenarë taktikë të ndërtuar mbi situata reale operacionale, ishin pjesë e këtij trajnimi.

Në këto momente, ku lodhja fizike arrinte kufijtë maksimalë, u testua ajo që përbën thelbin e një operatori



zbulimi: vullneti, qetësia dhe aftësia për të marrë vendime nën presion.

Kontroll dhe monitorim i vazhdueshëm

Gjatë gjithë zhvillimit të kursit, zbatimi i programit u ndoq nga afër nga Komanda dhe Shtabi i Regjimentit të Operacioneve Speciale. Kontrollët dhe vlerësimet u drejtuan nga zëvendëskomandanti i Regjimentit, nënkolonel Behar Mara, i cili monitoroi zbatimin e standardeve të trajnimit,



përgatitjen e kursantëve dhe realizimin e objektivave të programit.

Inspektimet në terren, gjatë marshimeve, ushtrimeve dhe testimeve përfundimtare, garantuan cilësinë dhe seriozitetin e këtij procesi të rëndësishëm për rritjen e kapaciteteve operacionale.

“Programi ka qenë jashtëzakonisht sfidues, si në aspektin teorik, ashtu edhe në atë praktik. Gjatë testimeve të vazhdueshme, një pjesë e kursantëve nuk arritën të përballonin kërkesat e këtij trajnimi intensiv. Ata që e përfunduan me sukses dëshmuar se zotërojnë aftësitë bazë që kërkon profesioni i operatorit të zbulimit”, – u shpreh komandanti i kursit, kapiten Enri Gjergji.

Instrukturë me përvojë operacionale

Në realizimin e këtij programi u angazhua një ekip instrukturësh me përvojë të gjatë në fushën e operacioneve speciale.

Kapiten Klevis Ademi drejtoi modulet për sistemet pa pilot (UAV), toger Krisman Merlika zhvilloi përgatitjen në fushën e HUMINT-it, nëntoger Desiol Uku trajtoi elementët e zbulimit të thellë, kryekapter Eligert Çela udhëhoqi modulet e specializuara të zbulimit, ndërsa nëntetar Hil Mala ishte përgjegjës për përgatitjen fizike.

Përvoja dhe profesionalizmi i tyre garantuan që çdo fazë e kursit të zhvillohej në përputhje me kërkesat e operacioneve speciale bashkëkohore.

Një traditë e re për strukturat e zbulimit

Kompania e Zbulimit është një nga strukturat më profesionale të Forcave të Armatosura. Nga një strukturë e Forcës Tokësore, ajo sot është pjesë e Regjimentit të Operacioneve Speciale, në varësi të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Personeli i saj ka marrë pjesë në misione të rëndësishme ndërkombëtare në mbështetje të paqes dhe sigurisë, duke dëshmuar profesionalizëm, disiplinë dhe përgatitje të lartë.

Kursi i Parë Bazë i Zbulimit nuk ishte thjesht një cikël trajnimi. Ai ishte një provë karakteri dhe një shkollë profesionale, ku çdo kursant mësoi se operatori i zbulimit nuk formohet vetëm në klasë.

Ai formohet në terren, nën diellin përvëlues, në netët pa gjumë, në lodhjen e marshimeve të gjata dhe në përgjegjësinë e çdo vendimi të marrë në kushtet më të vështira.

Certifikimi i 38 operatorëve të parë të zbulimit shënon fillimin e një tradite të re në përgatitjen e strukturave elitë të Forcave të Armatosura. Një traditë e ndërtuar mbi profesionalizmin, disiplinën dhe përkushtimin për t'i shërbyer me dinjitet Atdheut, Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe misioneve të Aleancës.

Sepse operatori i zbulimit është syri dhe veshi i forcës në çdo operacion. Ai nuk krijohet vetëm nga njohuritë, por nga karakteri që ndërtohet në çdo sfidë të përballuar.



FJALA QË NDËRTON NJERIUN DHE SHOQËRINË

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Nga një shprehje e urtë lind një filozofi e tërë jete

Jetojmë në kohën kur informacioni qarkullon me shpejtësinë e dritës, kur rrjetet sociale janë kthyer në tribunën e çdo mendimi dhe kur fjalët shpesh paraprijnë arsyen, katër këshillat e thjeshta të Dalai Lamës tingëllojnë më aktuale se kurrë: **“Nëse nuk është e jotja, mos e merr; Nëse nuk është e drejtë, mos e bëj; Nëse nuk është e vërtetë, mos e thuaj; Nëse nuk di gjë, rri urtë dhe mos fol”**.

Kodi moral nuk i përket vetëm një kulture apo një feje. Ai i përket njerëzimit. Është thirrje për ndërgjegje, për vetëkontroll dhe për përgjegjësi. Nëse këto katër parime do të zbatoheshin në jetën e përditshme, ndoshta bota do të ishte shumë më e drejtë, më e qetë dhe më njerëzore.

Mos merr atë që nuk është e jotja

Historia e njerëzimit është mbushur me konflikte që kanë lindur nga lakmia. Pasuria, pushteti, prona, privilegjet shpesh janë kërkuar duke cenuar të drejtat e tjetrit.

Por vjedhja nuk fillon vetëm kur dikush merr një send. Ajo nis edhe kur merret padrejtësisht mundi i një njeriu, kur përvetësohet puna e tij, kur mohohen të drejtat, kur uzurpohet dinjiteti.

Një shoqëri ku secili respekton atë që i përket tjetrit ndërton besim.

Besimi është kapitali më i madh që mund të ketë një komb. Kur ai humbet, humbet edhe siguria, bashkëjetesa dhe drejtësia.

Në fund të fundit, njeriu nuk pasurohet nga ajo që merr padrejtësisht, por nga ajo që fiton me ndershmëri.

Mos bëj atë që nuk është e drejtë

Drejtësia nuk është vetëm çështje ligjesh. Është mbi të gjitha çështje ndërgjegjeje. Shpesh ligji mund të vonojë, por ndërgjegjia flet menjëherë. Sa herë kemi parë njerëz që justifikojnë veprime të padrejta vetëm sepse “kështu bëjnë të gjithë”? Por e keqja nuk bëhet e mirë vetëm sepse përsëritet shumë herë. Një vend nuk ndërtohet vetëm me institucione të forta. Ai ndërtohet me qytetarë që refuzojnë padrejtësinë edhe kur askush nuk i sheh. Drejtësia fillon nga vendimet më të vogla të jetës sonë.

Mos thuaj atë që nuk është e vërtetë

Fjala është arma më e fuqishme që ka njeriu. Ajo mund të ngrejë një jetë, por edhe ta shkatërrojë atë. Sot jetojmë **në epokën e informacionit, por** paradoksalisht edhe në epokën e dezinformimit. Një lajm i pavërtetë përhapet brenda sekondave. Një shpifje mund të njollojë reputacionin e një njeriu për gjithë jetën. Një gënjeshtër mund të ndezë konflikte që zgjasin me vite. Prandaj përgjegjësia për të folur me të vërtetën nuk është vetëm detyrë e gazetarëve, historianëve apo studiuesve. **Është detyrë e çdo qytetari.** Shoqëria ka nevojë për njerëz që verifikojnë përpara se të flasin, që dëgjojnë përpara se të gjykojnë dhe që mendojnë përpara se të shpërndajnë një informacion. E vërteta ndonjëherë ecën ngadalë. Por ajo mbërrin gjithmonë.

Kur nuk di, hesht

Kjo është ndoshta këshilla më e vështirë për t'u zbatuar në kohën tonë. Sot secili ndihet i detyruar të japë mendim për gjithçka. Pa njohuri. Pa informacion. Pa përgjegjësi. Heshtja nuk është dobësi. Ajo është mençuri. Njeriu i ditur nuk flet për të treguar sa di. Ai flet vetëm kur ka diçka me vlerë për të thënë. Sa debate do të shmangeshin sikur njerëzit të pranonin me qetësi fjalën: **“Nuk e di.”** Pranimi i padijes është hapi i parë drejt dijes.

Një mësim për kohën tonë

Në një botë ku polarizimi po rritet, ku gjuha e urrejtjes po zë vendin e dialogut dhe ku shpesh zhurma mbizotëron mbi arsyen, këto fjali janë një manual i shkurtër i qytetarisë.

Nuk është rastësi që mësimet e ngjashme gjenden në traditën shqiptare. Të parët tanë thoshin: **“Fjala peshon më shumë se guri”**. Ata e dinin se karakteri i një njeriu nuk matet me pasurinë që ka, por me mënyrën si sillet me të tjerët.

Një mesazh që nuk plaket

Nuk ka rëndësi nëse këto fjalë vijnë nga Lindja apo Perëndimi. Ato flasin gjuhën universale të moralit. Një fëmijë



që rritet me këto parime bëhet qytetar i mirë. Një mësues që i zbaton edukon breza më të drejtë. Një gazetar që i respekton mbron të vërtetën. Një gjyqtar që jeton me to forcon besimin te drejtësia. Një politikan që i ndjek fiton respektin, jo vetëm pushtetin. Një popull që i kthen në mënyrë jetese ndërton një shtet më të fortë.

Njeriu nuk kujtohet për atë që ka grumbulluar, por për atë që ka lënë pas. Pasuria humbet, pushteti kalon, fama venitet, por ndershmëria, drejtësia dhe e vërteta mbeten trashëgimia më e çmuar.

Nëse secili prej nesh do të ndalonte për një çast përpara se të merrte atë që nuk i përket, përpara se të bënte një padrejtësi, përpara se të thoshte një gënjeshtër ose përpara se të fliste pa ditur, ndoshta do të kishim më pak konflikte, më shumë besim dhe më shumë paqe.

Qytetërimi nuk matet me ndërtesat që ngremë, por me vlerat që mbrojmë. Dhe shprehja **“Nëse nuk është e jotja, mos e merr; Nëse nuk është e drejtë, mos e bëj; Nëse nuk është e vërtetë, mos e thuaj; Nëse nuk di gjë, rri urtë dhe mos fol”**, përbën shtyllat mbi të cilat mund të ndërtohet jo vetëm karakteri i një njeriu të mirë, por edhe e ardhmja e një shoqërie të drejtë.

Nuk kam synuar thjesht të sjell ngjarje historike apo të dokumentoj fakte, por të përcjell te lexuesi mesazhin se vlerat njerëzore janë themeli mbi të cilin ndërtohet karakteri i individit dhe forca e një kombi. Besoj se ndershmëria, respekti, përgjegjësia, e vërteta dhe dashuria për Atdheun nuk

janë nocione të vjetra që u përkasin vetëm librave të historisë. Ato janë vlera të përhershme, të cilat duhet të shoqërojnë çdo njeri në jetën e tij të përditshme. Vetëm një njeri që rritet me këto parime mund të bëhet një qytetar i denjë, i aftë të japë kontribut në familje, në komunitet, në institucionet ku punon dhe në zhvillimin e vendit.

Nëse brezat e rinj do të edukohen me bindjen se suksesi nuk ndërtohet mbi mashtrimin, se dinjiteti nuk blihet me pushtet dhe se respekti fitohet me punë e integritet, atëherë edhe shoqëria jonë do të jetë më e drejtë dhe më e fortë. Kjo është arsyeja pse në shkrimet e mia kam zgjedhur gjithmonë të evidentoj modelet pozitive, figurat që kanë shërbyer me përkushtim dhe historitë që frymëzojnë.

Jam e bindur se çdo autor ka një përgjegjësi përpara lexuesit. Fjala e shkruar nuk duhet të shërbejë për të nxitur përçarje apo urrejtje, por për të ndërtuar ndërgjegje, për të kultivuar kulturën e dialogut dhe për të forcuar besimin te vlerat që e bëjnë njeriun më të mirë.

Pasuria më e madhe që mund t'u lëmë brezave nuk janë vetëm librat që shkruajmë, por mesazhet që mbjellim përmes tyre. Nëse qoftë edhe një i ri, pas leximit të një shkrimi, zgjedh të jetë më i ndershëm, më i drejtë, më i përgjegjshëm dhe më i përkushtuar ndaj shoqërisë, atëherë pena ka përmbushur misionin e saj më fisnik.

Për mua, ky ka qenë dhe do të mbetet motivimi kryesor i çdo shkrimi që kam botuar.

20 KORRIK 1957 – DITA QË INSTITUCIONALIZOI KUJTESËN E LUFTËS ANTIFASHISTE



PROF. DR. ELIDJANA CANAJ

69-vjetori i Organizatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar “Nderi i Kombit”

Kombet historinë e tyre nuk e ruajnë vetëm në arkiva, monumente apo përvjetorë. Ajo mbijeton përmes institucioneve që kanë mision të mbajnë të gjallë kujtesën historike dhe të përcjellin te brezat vlerat mbi të cilat është ndërtuar shteti. Për Shqipërinë, një nga këto institucione është Organizata e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar, e krijuar, **më 20 korrik 1957, vetëm trembëdhjetë vjet pas Çlirimit të vendit.**

Kjo datë shënon lindjen e një organizate që u ngrit për të bashkuar veteranët e luftës, për të ruajtur trashëgiminë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe për të mbrojtur kujtesën e sakrificave të një brezi që kontribuoi në çlirimin e Shqipërisë nga pushtimi nazifashist. Në themel të veprimtarisë së saj qëndroi edukimi atdhetar, respekti për dëshmorët dhe veteranët, si edhe dokumentimi i kontributit të popullit shqiptar në luftën antifashiste.

Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare përbën një nga kapitujt më të rëndësishëm të historisë moderne shqiptare. Në këtë luftë u organizuan formacione të shumta partizane, të cilat u zhvilluan gradualisht deri në krijimin e një ushtrie të rregullt nacionalçlirimtare me Shtabin e Përgjithshëm, brigada, divizione dhe një organizim të plotë ushtarak. Krahës luftëtarëve, në këtë përpjekje morën pjesë komandantë, komisarë, mjekë, infermierë, intendentë, të rinj e të reja, gra dhe vajza, si edhe organizata të tilla si DEBATIK-u, duke e kthyer luftën në një përpjekje gjithë-popullore.

Çmimi i lirisë ishte i lartë. Mbi 28 mijë dëshmorë dhanë jetën për çlirimin e vendit, ndërsa shumë të tjerë mbetën invalidë ose u përballën me sakrificat të mëdha gjatë viteve të luftës. Kontributi i Shqipërisë u njoh ndërkombëtarisht si pjesë e koalicionit antifashist fitues në Luftën e Dytë Botërore.

Që nga krijimi i saj, Organizata e Veteranëve u bë zëri institucional i këtij brezi. Ajo u angazhua në ruajtjen e dokumentacionit historik, organizimin e veprimtarive përkujtimore, botimin e kujtimeve dhe dëshmive të veteranëve, si dhe në edukimin patriotik të brezit të ri. Në dekadat që pasuan, organizata u shndërrua në një urë lidhëse mes historisë dhe shoqërisë shqiptare.

Edhe pas ndryshimeve politike të viteve ‘90, organizata vijoi veprimtarinë e saj duke u riorganizuar sipas legjisllacionit të ri dhe duke ruajtur identitetin e saj historik. Besnikëria ndaj dokumenteve themelore, respektimi i ligjit dhe bashkëpunimi me institucionet shtetërore, pushtetin vendor dhe organizata të tjera shoqërore kanë qenë ndër elementët që i kanë dhënë vazhdimësi dhe autoritet veprimtarisë së saj.



Një vlerësim i rëndësishëm për këtë kontribut erdhi në vitin **2019**, kur Organizata e Veteranëve dhe Pasardhësve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar u dekorua me titullin **“Nderi i Kombit”**, me rastin e 75-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë. Ky titull përfaqëson një mirënjohje institucionale për rolin që organizata ka luajtur në ruajtjen e kujtesës historike dhe në promovimin e vlerave patriotike.

Po në vitin 2019, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi Ligjin nr. 67/2019, i cili ndryshoi ligjin “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, duke përcaktuar zyrtarisht **20 Korrikun si “Ditën e Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar”**. Ky akt ligjor i dha kësaj date një status kombëtar, duke e shndërruar atë në një ditë nderimi për të gjithë veteranët dhe familjet e tyre.

Sot Organizata e Veteranëve dhe Pasardhësve përfshin mijëra anëtarë veteranë, pasardhës, bij e bija, nipa e mbesa të veteranëve, invalidëve dhe dëshmorëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Përmes veprimtarive të

saj në Shqipëri dhe në diasporë, ajo vijon të mbajë gjallë kujtesën historike, të promovojë idealet e lirisë dhe të kontribuojë në edukimin qytetar e patriotik të brezave të rinj.

Në një kohë kur historia kërkon gjithnjë e më shumë dokumentim, analizë dhe kujtesë, 20 Korriku mbetet një datë me vlerë të veçantë. Ai nuk është vetëm përvjetori i një organizate, por simbol i respektit ndaj një brezi që luftoi për lirinë e vendit dhe që, edhe pas përfundimit të luftës, punoi për të ruajtur trashëgiminë morale e historike të saj.

Në këtë 69-vjetor të themelimit të Organizatës së Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të Popullit Shqiptar, nderimi u takon të gjithë veteranëve, dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe pasardhësve të tyre, të cilët vazhdojnë të mbajnë gjallë kujtesën e një prej periudhave më të rëndësishme të historisë së shtetit shqiptar.

Lavdi luftëtarëve të lirisë! Lavdi dëshmorëve të Atdheut! Nderim veteranëve dhe familjeve të tyre!

Transformimi i universitetit tradicional në universitet 4.0, në epokën e inteligjencës artificiale dhe teknologjisë së avancuar digjitale



MAJOR @ MSC. AGRON BUKAÇI
Specialist/Kërkues në IKSHU/AFA

Ky artikull sjell për lexuesit e shtypin ushtarak një analizë lidhur me transformimin e universitetit civil dhe ushtarak tradicional drejt modelit të universitetit 4.0 civil dhe ushtarak në epokën e zhvillimit të shpejtë të inteligjencës artificiale (IA), internetit të gjërave (IoT) dhe teknologjisë së avancuar digjitale. Në kushtet e revolucionit të katërt industrial 4.0, arsimit universitar civil dhe ushtarak përballen me sfida të reja që në aspektin ushtarak lidhen me natyrën e luftës moderne, e cila karakterizohet nga dimensione kibernetike, hibride dhe të bazuara në informacion.

Një nga sfidat e ditëve të sotme sa i përket arsimit të lartë, në përgjithësi ku përfshihet edhe arsimit i lartë ushtarak, është transformimi i universitetit tradicional në universitet 4.0, i lidhur me industrinë 4.0. Kodi 4.0 është një akronim për revolucionin e katërt industrial, ku përfshihet edhe industria ushtarake.

Transformimi i universitetit tradicional në universitetin 4.0 sjell një revolucion në arsimin e lartë civil dhe ushtarak, duke e tejkaluar modelin tradicional dhe duke e përshtatur arsimin e lartë me epokën digjitale, ky model është një hap i madh drejt një arsimit më të hapur, më përfshirës dhe më të orientuar nga e ardhmja. Duke qenë se universiteti 4.0 është i lidhur me industrinë 4.0, në këtë shkrim do të trajtohen çështje që lidhen me industrinë 4.0, industri që aplikojnë teknologji të avancuar digjitale, teknologji që përfshijnë Internetin e gjërave, *cloud computing*, AI, mësimin e makinerive (nënfushë e AI-së që mëson nga të dhënat) dhe *edge computing* (përpunimi i të dhënave në skaj, afër burimit). Investimi në këto teknologji do t'i ndihmojë kompanitë të qëndrojnë konkurruese në tregun modern, gjithashtu do t'i bëjë kompanitë më tërheqëse për punëtorët e rinj.

Vlerësimi i hulumtimit që do të kryhet brenda këtij programi investimi që përfshin një gamë të gjerë jo vetëm në inxhinieri, FA, por edhe në shkencat shoqërore, mjekësi dhe madje edhe në drejtësi do të përshpejtojë procesin e integritetit të industrisë 4.0 në universitete. Kështu, me ndryshimin e qëllimeve dhe metodave të të nxënies të programeve akademike të avancuara, është e natyrshme të pritet që industria të ndikojë në programet dhe metodat arsimore në universitete.

Industria 4.0 dhe universiteti 4.0

Lidhja ndërmjet universitetit 4.0 dhe industrisë 4.0 ndër të tjera qëndron në faktin se përshtatja e fuqisë punëtore, e cila do të preket më shumë nga procesi i industrisë 4.0 dhe përgatitja e saj për nevojat e reja do të kryhet kryesisht nga universitetet dhe qendrat kërkimore shkencore.

Klaus Schwab - ekonomist dhe inxhinier gjerman, i njohur si themeluesi dhe kryetari ekzekutiv i Forumit Ekonomik Botëror, një platformë që bashkon liderët globalë për të diskutuar dhe formësuar agjendat ekonomike dhe sociale, e përcakton revolucionin e katërt industrial si një arritje të kohës se si teknologjitë në zhvillim po bashkojnë botët fizike, digjitale dhe biologjike, duke transformuar në thelb ekonominë, shoqëritë dhe jetën njerëzore.

Në epokën e revolucionit të katërt industrial, Klaus Schwab argumenton se po hyjmë në një periudhë ndryshimi, ndryshe nga çdo revolucion i mëparshëm industrial, i karakterizuar nga shpejtësia, fushëveprimi dhe ndikimi sistematik. Ndryshe nga tre revolucionet e para industriale, të cilat prezantuan prodhimin mekanik, prodhimin masiv dhe automatizimin dixhital, revolucionin e katërt dallohet nga integrimi i teknologjive të tilla si inteligjenca artificiale, robotika, interneti i gjërave, automjetet autonome, printimi 3D, nanoteknologjia, bioteknologjia dhe informatika kuantike, të cilat po riformësojnë industrinë, qeveritë dhe shoqëritë në nivel global.

Schwab e vendos revolucionin e katërt industrial brenda një kuadri historik si më poshtë:

Revolucioni i Parë Industrial (1760–1840): Kalimi nga fuqia muskulore në atë mekanike nëpërmjet motorëve me avull dhe hekurudhave.

Revolucioni i Dytë Industrial (fundit i shekullit të 19-të - fillimi i shekullit të 20-të): Prodhimi masiv i mundësuar nga energjia elektrike dhe linjat e montimit.

Revolucioni i Tretë Industrial (vitet 1960 e në vazhdim): Automatizimi përmes elektronikës, kompjuterëve dhe internetit.

Revolucioni i Katërt Industrial (aktualisht): Bashkimi i sistemeve fizike, digjitale dhe biologjike, me një shpejtësi të paparë dhe shtrirje globale.



Universiteti 4.0, koncepti i ri i transformimit të arsimit të lartë në epokën digjitale

Universiteti 4.0 është një hap i madh drejt një arsimit më të hapur, më përfshirës dhe më të orientuar nga e ardhmja.

“Organisation for Economic Co-operation and Development (OECD) - Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, thekson se teknologjia digjitale po transformon arsimin, duke rritur aksesin, angazhimin, personalizimin dhe duke i përgatitur studentët për një të ardhme digjitale, transformimi digjital në arsim kërkon rikonceptim të plotë të proceseve mësimore dhe organizative, dhe jo vetëm përdorim të teknologjisë.

Universiteti 4.0 sjell një revolucion në arsimin e lartë, duke e tejkaluar modelin tradicional dhe duke e përshtatur me epokën digjitale. Ja disa nga avantazhet kryesore që e dallojnë universitetin 4.0 nga modelet e mëparshme të universitetit tradicional:

Avantazhet kryesore të universitetit 4.0 ndaj universitetit tradicional:

Personalizim i mësimit: Përdorimi i inteligjencës artificiale dhe analizës së të dhënave lejon krijimin e përvojave të mësimi të përshtatura për secilin student.

Fleksibilitet në formimin akademik: Mësimi zhvillohet në kampuse fizike dhe virtuale, duke i dhënë studentëve mundësinë të mësojnë nga kudo dhe në çdo kohë.

Lidhje direkte me tregun e punës: Programet akademike janë të orientuara drejt aftësive që kërkohen nga ekonomia 4.0, si teknologjia, inovacioni dhe kreativiteti.

Mësim gjatë gjithë jetës: Universiteti nuk është më vetëm për të rinjtë, por për çdo individ që kërkon të zhvillojë aftësitë e tij në çdo fazë të jetës.

Kërkim shkencor i avancuar: Rritje e financimit për kërkimin shkencor dhe bashkëpunim me industrinë për zgjidhje reale dhe inovative.

Ndërkombëtarizim dhe digjitalizim: Bashkëpunim me universitete ndërkombëtare dhe krijimi i kampuseve online për të rritur cilësinë dhe aksesin në edukim.

Modeli	Fokus kryesor	Teknologji	Lidhje me tregun	Mësim fleksibël
Universiteti 1.0	Mësim tradicional në auditorë	Jo	I kufizuar	Jo
Universiteti 2.0	Integrim i teknologjisë bazike	Po	Fillestar	I pjesshëm
Universiteti 3.0	Fokus në kërkim dhe inovacion	Po	Më i fortë	Po
Universiteti 4.0	Personalizim, digjitalizim, globalizim	Po	I drejtpërdrejtë	Maksimal

Tabelë krahasuese e universitetit 4.0 me universitetet e tjerë

Duke qenë se universiteti civil dhe ushtarak 4.0 gjithashtu, janë në kontekstin e zhvillimit të shpejtë të inteligjencës artificiale (IA), internetit të gjërave (IoT) dhe teknologjive të avancuara digjitale, cloud computing, këto elementë do t'i cekim shkurtimisht.

Interneti i gjërave (IoT) është një rrjet objektsh fizike - siç janë pajisjet, automjetet, pajisjet dhe makinat industriale - të integruara me sensorë, softuerë dhe lidhshmëri që i mundësojnë atyre të mbledhin, shkëmbejnë dhe veprojnë mbi të dhënat pa ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të njeriut. Këto pajisje “inteligjente” mund të variojnë nga termostatat shtëpiakë dhe gjurmuesit e fitnesit të veshshëm deri te automjetet autonome dhe sistemet industriale në shkallë të gjerë.

Komponentët kryesorë të IoT përfshijnë:

Sensorët dhe aktuatorët, të cilët sinjalin elektrik, digjital e kthejnë në veprim fizik, sensorët zbulojnë ndryshimet mjedisore p.sh., temperaturën, lëvizjet, etj.

Lidhshmëria - Teknologjitë si Wi-Fi, Bluetooth, Zigbee - protokoll komunikimi me rreze të shkurtër, shtëpi inteligjente (smart home), celulari dhe LoRaWAN - protokoll komunikimi me rreze të gjatë, për qytete inteligjente (smart cities), transmetojnë të dhëna.

Cloud Computing - Ruan, përpunon dhe analizon të dhënat e IoT në shkallë të gjerë.

Të dhënat e mëdha (big data) dhe IA - Nxjerrin informacione, zbulojnë anomalitë dhe mundësojnë analiza parashikuese.

Kornizat e Sigurisë - Enkriptimi, autentifikimi dhe zbulimi i ndërhyrjeve për të mbrojtur pajisjet dhe të dhënat.

Në industrinë e kujdesit shëndetësor, pajisjet IoT mund të përdoren për të monitoruar pacientët nga distanca dhe për të mbledhur të dhëna në kohë reale mbi parametrat e tyre jetësore, të tilla si rrahjet e zemrës, presioni i gjakut dhe ngopja me oksigjen. Këto të dhëna të sensorëve mund të analizohen për të zbuluar modelet dhe për të identifikuar problemet e mundshme shëndetësore përpara se ato të bëhen më serioze. Pajisjet IoT mund të përdoren gjithashtu për të ndjekur pajisjet mjekësore, për të menaxhuar inventarin dhe për të monitoruar pajtueshmërinë me ilaçet.

Përdorimi i internetit të gjërave IoT në aspektin ushtarak

Në aspektin ushtarak pajisjet e IoT emërtohen “Internet of Military Things” (IoMT) ose “Internet of Battlefied Things” dhe gjejnë përdorim të gjithanshëm në fushën e luftimit si sensorë në terren, dronë me kamera inteligjente, kamera dhe radarë të lidhur në rrjet, sensorë biometrik dhe pajisje që integrohen në pajisjet personale të çdo ushtaraku të përfshirë drejtpërdrejt në luftim ose si forcë mbështetëse e luftimit.

Përdorimi i pajisjeve të IoMT në luftim sjell vendimmarrje të shpejtë dhe të saktë, integrim total të forcave, ndërgjegjësim të lartë institucional rreth situatës, reduktim të rrezikut për forcat e luftimit dhe të mbështetjes së luftimit.

Zbatimet Ushtarake të IoMT

Ndërgjegjësim i përmirësuar në fushën e betejës, automjete dhe dronë autonomë, logjistika dhe menaxhimi i zinxhirit të furnizimit, teknologji e veshshme për ushtarët, siguria kibernetike dhe mbrojtja e rrjetit, programet aktive ushtarake të IoT, interneti i gjërave në fushën e betejës (IoBT) i DARPA-s, rrjeti i misionit të federuar (FMN) i NATO-s, projekti Maven.

Sistemet *ISR* Intelligence, Surveillance, Reconnaissance - Inteligjencë, Mbikëqyrje, Zbulim, sensor tokësor, radar, satelit, dronë, të gjitha të lidhura në një rrjet të vetëm, ku informacioni shpërndahet menjëherë në kohë reale tek komandat.

Programet IoMT të DARPA - *Defence Advanced Research Projects Agency* - Agjencia e Projekteve të Kërkimit të Avancuar të Mbrojtjes.

Ushtari i lidhur - *Connected Solder*, i pajisur me GPS, sensor lodhjeje, temperaturë, pajisje komunikimi, të integruara ku komandanti e sheh live pozicionin e ushtarit në fushëbetjeje. Automjetet dhe tanket smart.



Inteligjenca artificiale (IA) është teknologji që u mundëson kompjuterëve dhe makinave të simulojnë të mësuarit, të kuptuarit, zgjidhjen e problemeve, vendimmarrjen, kreativitetin dhe autonominë njerëzore.

Aplikacionet dhe pajisjet e pajisura me IA mund të shohin dhe identifikojnë objektet, ato mund të kuptojnë dhe t'i përgjigjen gjuhës njerëzore, mund të mësojnë nga informacione dhe përvoja të reja, mund të japin rekomandime të hollësishme për përdoruesit dhe ekspertët. Ato mund të veprojnë në mënyrë të pavarur, duke zëvendësuar nevojën për inteligjencë ose ndërhyrje njerëzore (një shembull klasik është një makinë që vetëdrejtohet, mjetet robotike që përdoren në fushën e luftimit, të EOD, etj.). Por në vitin 2024, shumica e studuesve, praktikuesve të IA-së dhe shumica e titujve kryesorë të lidhur me IA-në, janë të përqendruar në përparimet në IA-në gjeneruese (IA e gjeneratës), një teknologji që mund të krijojë tekst origjinal, imazhe, video dhe përmbajtje të tjera. Për ta kuptuar plotësisht IA-në gjeneruese, është e rëndësishme të kuptohen së pari teknologjitë mbi të cilat janë ndërtuar mjetet e IA-së gjeneruese, të mësuarit automatik (ML) dhe të mësuarit e thellë”. Në këtë kontekst, institucionet e arsimit ushtarak përballen me sfida të reja që lidhen me transformimin e natyrës së luftës dhe teknologjisë. Universiteti Ushtarak 4.0 lind si një përgjigje ndaj këtyre sfidave, duke integruar inteligjencën artificiale, IoT dhe analizën e të dhënave në procesin arsimor.

Inteligjenca artificiale (IA) po transformon me shpejtësi fushën ushtarake, me implikime të thella për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare. Deri vonë, diskutimet shumëpalëshe mbi përdorimet ushtarake të IA-së ishin të kufizuara në pyetjen se si kjo teknologji lidhet me sistemet autonome të armëve vdekjeprurëse – Lethal Autonomous-Weapons-System (LAWS) - një fushë e rëndësishme por e ngushtë aplikimi. Megjithatë, në fund të vitit 2024, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi një rezolutë historike që njohu gamën e gjerë të aplikimeve ushtarake të IA-së dhe bëri thirrje për shqyrtimin e kësaj teknologjie në fushën ushtarake përtej sistemeve të armëve. Kjo rezolutë u ndërtua mbi ndërgjegjësimin në rritje për IA-në në fushën ushtarake dhe rritjen e tërheqjes së saj politike gjatë 3 viteve të fundit.

(Vijon në numrin e ardhshëm)

LUFTA NUK KA FITUES

Paqja nuk është dobësi, është forca më e madhe e qytetërimit

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

“Një komb që harron historinë e luftërave të tij, rrezikon të mos njohë vlerën e paqes”

Nga iluzioni i paqes drejt realitetit të ri të sigurisë

Për më shumë se tri dekada pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, Evropa jetoi me bindjen se konfliktet e mëdha ushtarake i përkisnin së shkuarës. Rënia e Murit të Berlinit, shpërbërja e blloqeve ushtarake dhe zgjerimi i institucioneve euroatlantike krijuan idenë se kontinenti kishte hyrë në një epokë të re, ku diplomacia, ekonomia dhe bashkëpunimi do të zëvendësonin armët.

Megjithatë, historia ka treguar vazhdimisht se paqja nuk është një gjendje e përhershme. Ajo nuk është një e drejtë e fituar përgjithmonë, por një ekuilibër i brishtë që duhet mbrojtur çdo ditë.

Lufta në Ukrainë e rrëzoi këtë iluzion. Brenda pak javësh, Evropa u përball me një realitet që brezat e rinj e njihnin vetëm nga librat e historisë. Qytete të bombarduara, miliona refugjatë, infrastrukturë e shkatërruar dhe një konflikt që vazhdon të ndikojë jo vetëm në fatin e një shteti, por në sigurinë e gjithë kontinentit.

Asnjë luftë nuk mbetet e izoluar

Në botën e sotme, çdo konflikt përhap pasoja ekonomike, politike, sociale dhe humanitare përtej kufijve ku zhvillohet. Pikërisht kjo po ndodh edhe sot. Çmimet e energjisë, tregjet ndërkombëtare, zinxhirët e furnizimit, migracioni dhe stabiliteti politik janë ndikuar drejtpërdrejt nga lufta.

Por mbi të gjitha, është cenuar besimi se paqja është e pakthyeshme. Ky është mësimi më i rëndësishëm që duhet të nxjerrë bota.

Lufta nuk matet me territore të pushtuara

Kur flitet për luftën, zakonisht analizohen hartat ushtarake. Diskutohen ofensivat. Numërohen tanket, avionët, raketat dhe sistemet moderne të armatimit. Por historia nuk mbahet mend për këto. Historia mbahet mend për njerëzit. Pas çdo harte ushtarake fshihet një qytet. Pas çdo qyteti fshihet një familje. Pas çdo familjeje fshihet një histori.

Lufta nuk shkatërron vetëm ura, aeroporte apo objekte strategjike. Ajo shkatërron jetën e përditshme. Fëmijët nuk shkojnë më në shkollë. Spitalet nuk funksionojnë normalisht. Bizneset mbyllen. Familjet ndahen. **Ëndrrat ndërpriten.** Një qytet që dikur gumëzhinte nga jeta, brenda pak javësh mund të kthehet në një peizazh të heshtur. Asnjë raketë nuk godet vetëm një objekt. Ajo godet kujtime. Godet fëmijëri. Godet të ardhmen. Prandaj lufta nuk është kurrë një statistikë. **Është një dramë njerëzore.** Edhe kur një konflikt përfundon, pasojat vazhdojnë për dekada. Traumat psikologjike kalojnë nga një brez te tjetri. Ekonomia kërkon vite për t'u rindërtuar. Besimi mes njerëzve rikthehet shumë më ngadalë sesa rindërtohen ndërtesat.

Historia e Evropës pas Luftës së Dytë Botërore e dëshmon këtë më mirë se çdo libër.

Mësimet që po jep Ukraina

Lufta në Ukrainë nuk është vetëm një konflikt rajonal. Ajo është një laborator ku po testohen konceptet moderne të sigurisë. Po provohet rëndësia e teknologjisë. Po provohet rëndësia e inteligjencës. Po provohet rëndësia e logistikës. Po provohet rëndësia e informacionit. Por mbi të gjitha, po provohet rëndësia e rezistencës së një shoqërie.

Një ushtri nuk lufton e vetme. Ajo mbështetet nga qytetarët. Nga ekonomia. Nga industria. Nga infrastruktura.



Nga sistemi shëndetësor. Nga administrata. Nga mediat. Nga partnerët ndërkombëtarë. Siguria kombëtare nuk është më vetëm çështje ushtarake. Ajo është përgjegjësi kombëtare. Ky është ndryshimi më i madh që ka sjellë konflikti. Sot flitet për “reziliencë kombëtare”, sepse është kuptuar se një shtet është aq i fortë sa janë institucionet dhe qytetarët e tij.

Forcat e Armatosura, garancia e paqes

Ekziston një paradoks që historia e ka vërtetuar shumë herë. Paqja ruhet nga ata që janë të përgatitur për ta mbrojtur. Një ushtri moderne nuk ekziston sepse dëshiron luftën. Përkundrazi. Ajo ekziston që lufta të mos ndodhë. Kjo është filozofia mbi të cilën është ndërtuar NATO. Mbrojtja kolektive nuk është koncept agresioni. **Është koncept parandalimi.** Kur një shtet ka institucione të forta, një ushtri profesionale dhe aleatë të besueshëm, rritet mundësia që konflikti të mos shpërthejë.

Prandaj investimi në mbrojtje nuk është investim për luftën. **Është investim për paqen.**

Shqipëria në arkitekturën e re të sigurisë

Shqipëria sot është pjesë e sistemit më të madh të sigurisë kolektive në botë. Anëtarësimi në NATO nuk është vetëm një garanci sigurie. **Është edhe përgjegjësi.** Forcat tona të Armatosura kanë dëshmuar profesionalizëm në Afganistan, Kosovë, Bosnje-Hercegovinë, Letoni, Bullgari dhe në shumë misione të tjera ndërkombëtare.

Ushtarët shqiptarë kanë treguar se dinë të bashkëpunojnë me aleatët, të respektojnë standardet më të larta profesionale dhe të përfaqësojnë me dinjitet flamurin shqiptar. Sot modernizimi i Forcave të Armatosura nuk është luks.

Është domosdoshmëri. Teknologjia ushtarake ndryshon me ritme të jashtëzakonshme. Lufta në Ukrainë ka treguar se dronët, inteligjenca artificiale, lufta elektronike dhe sistemet e mbrojtjes ajrore po ndryshojnë mënyrën se si zhvillohen konfliktet. Kjo kërkon investime të vazhdueshme. Kërkon arsimim. Kërkon stërvitje. Kërkon bashkëpunim ndërkombëtar.

Paqja nuk ndërtohet vetëm me armë

Do të ishte gabim të besojmë se siguria varet vetëm nga ushtria. Siguria fillon te shkolla. Te familja. Te edukimi. Te respekti për ligjin. Te ekonomia. Te demokracia. Te institucionet.

Një shoqëri e bashkuar është shumë më e fortë se çdo sistem armësh. Pikërisht për këtë arsye, lufta në Ukrainë ka nxjerrë në pah edhe rëndësinë e solidaritetit ndërkombëtar. Ndhima humanitare. Mbështetja ekonomike.

Bashkëpunimi diplomatik. Mbrojtja e civilëve. Të gjitha këto janë pjesë e së njëjtës betejë për paqen.

Përse nuk duhet të harrojmë

Historia është kujtesa e kombeve. Kur ajo harrohet, gabimet përsëriten. Evropa ndërtoi paqen mbi kujtesën e Luftës së Dytë Botërore. Sot ajo duhet ta mbrojë atë me të njëjtën vendosmëri. Sepse paqja nuk është vetëm mungesa e armëve. Paqja është zhvillim. **Është mirëqenie. Është demokraci. Është liri. Është e drejta e çdo qytetari për të jetuar pa frikë.** Ky është misioni i çdo shteti demokratik. Ky është edhe misioni i Forcave të Armatosura. Jo të nxisin luftën. Por ta pengojnë atë. Jo të ndërtojnë konflikte. Por të mbrojnë jetën. Në fund të fundit, uniforma ushtarake nuk simbolizon vetëm forcën. Ajo simbolizon përgjegjësinë. Përgjegjësinë për të mbrojtur vendin. Për të mbrojtur qytetarët.

Për të mbrojtur paqen. Dhe pikërisht këtu qëndron dallimi mes një ushtrie moderne dhe luftës. Lufta sjell shkatërrim. Ushtria mbron sigurinë. Lufta krijon viktima. Ushtria mbron jetën. Lufta ndërpret të ardhmen. Forcat e Armatosura punojnë që ajo të ekzistojë.

Në një kohë kur bota po përballlet me sfida të reja gjeopolitike, mesazhi që duhet të mbetet i qartë është vetëm një: **paqja nuk është dobësi. Ajo është shprehja më e lartë e forcës së një kombi. Dhe detyra e çdo ushtrie profesioniste është ta mbrojë atë me përkushtim, gatishmëri dhe përgjegjësi.**

Sepse historia nuk do të kujtojë vetëm ata që fituan betejë. Ajo do të nderojë ata që arritën të ruanin paqen.

KOLONEL IMER SELIM HOTAJ

Një jetë në shërbim të Atdheut, Armës së Xhenios dhe Forcave të Armatosura

Ka emra që mbeten të gdhendur në kujtesë jo për fjalët që thanë, por për jetën që jetuan dhe shembullin që lanë pas. **Kolonel Imer Selim Hotaj** ishte një prej tyre. Ai ia kushtoi gjithë jetën shërbimit ndaj Atdheut, duke e veshur uniformën me dinjitet, përkushtim dhe ndjenjë të lartë përgjegjësie.

Ndarja e tij nga jeta është një humbje për familjen, për miqtë, për bashkëluftëtarët e kolegët, por edhe për historinë e **Armës së Xhenios**, së cilës ai i kushtoi dekada të tëra pune, dijeje dhe përkushtimi.

I lindur më **12 shtator 1934**, në Koplik të Malësisë së Madhe, në një familje të thjeshtë me tradita të forta patriotike dhe mbështetëse të Luftës Nacionalçlirimtare, Imer Hotaj u rrit me ndjenjën e respektit për punën, sakrificën dhe dashurinë për vendin.

Ishin pikërisht këto vlera që do ta shoqëronin gjatë gjithë jetës, duke formuar personalitetin e një ushtaraku të ndershëm dhe të palodhur.

Arsimin fillor dhe shtatëvjeçar e kreu në vendlindje, ndërsa studimet e mesme në Tiranë, ku u dallua për rezultatet e larta dhe seriozitetin në mësimet. Dashuria për profesionin ushtarak e çoi në **Shkollën e Bashkuar të Oficerëve**, ku në vitet 1953–1956 kreu me sukses specialitetin e xhenios, duke fituar gradën **nëntoger**.

Që në detyrat e para u shqua si një oficer i aftë, me kulturë profesionale dhe ndjenjë të lartë përgjegjësie. Në Regjimentin e Parë Xhenier në Elbasan ai u bë pjesë e brezit të oficerëve që morën përsipër ndërtimin e objekteve të rëndësishme ushtarake dhe infrastrukturës së mbrojtjes së vendit.

Kontributi i tij shtrihet në shumë vepra xheniere, në Klenjë, Dajt, Kala e Turrës, Curilë, Orikum dhe në aksin rrugor Orikum–Pashaliman.

Çdo objekt mbante vulën e profesionalizmit dhe të përkushtimit të brezit të tij, një brez që punonte në heshtje, larg vëmendjes, por me përgjegjësi të jashtëzakonshme për sigurinë dhe mbrojtjen e vendit.

Një kapitull i rëndësishëm në jetën e tij mbetet realizimi i punimeve për **hapjen e Kanalit të Çukës në Sarandë**, një nga ndërhyrjet më të vështira xheniere të kohës. Në kushte tepër të vështira gjeologjike, në terren moçalor e shkëmbor, ai dhe kolegët e tij përballuan me sukses një operacion kompleks shpërthimesh dhe gërmimesh. Ishte një punë që kërkonte jo vetëm njohuri teknike, por edhe guxim, vendosmëri dhe përgjegjësi të jashtëzakonshme. Për realizimin me sukses të këtij projekti, grupi u vlerësua nga drejtuesit më të lartë të shtetit.

Vullneti për t'u përgatitur gjithnjë e më mirë profesionalisht bëri që në vitin 1958 të dërgohej për studime në **Shkollën e Lartë të Inxhinierisë Elektronike Ushtarake në Leningrad**,



Ata që e kanë njohur nga afër kujtojnë një njeri të urtë, me fjalë të pakta, por me autoritet të padiskutueshëm. Nuk kërkonte privilegje dhe nuk e shfaqte kurrë punën e tij. Besonte se detyra kryhej në heshtje dhe se shpërblimi më i madh për një ushtarak ishte ndërgjegjia e pastër se kishte bërë më të mirën për vendin.

Përtej uniformës, Imer Hotaj ishte një bashkëshort i përkushtuar, një prind shembullor, si gjithë, ai ishte një figurë e dashur dhe frymëzuese. Me durimin, buzëqeshjen dhe fjalën e tij të mençur, ai la kujtime të paharrueshme në zemrat e dy mbesave, duke u bërë për to një shembull i gjallë i dinjitetit, përgjegjësisë dhe dashurisë pa kushte. Trashëgimia më e çmuar që u la atyre nuk ishte vetëm historia e jetës së tij, por edhe vlerat me të cilat i edukoi dhe shembulli që u dha çdo ditë. dhe një qytetar i respektuar. Ai edukoi familjen me të njëjtat parime që udhëhoqën jetën e tij, ndershmërinë, korrektësinë, respektin për njerëzit dhe dashurinë për Shqipërinë.

Brezi të cilit ai i përkiste ndërtoi në heshtje themelet e shumë kapaciteteve të Forcave të Armatosura shqiptare. Ishin oficerë që punuan larg vëmendjes publike, pa kërkuar lavdi personale, por me bindjen se shërbimi ndaj Atdheut ishte detyrimi më i lartë moral.

Jeta dhe vepra e tij janë një dëshmi se profesionalizmi, përkushtimi dhe ndershmëria nuk zbehen me kalimin e viteve. Ata mbeten trashëgimi për brezat që vijnë dhe model për çdo ushtarak që zgjedh t'i shërbejë Atdheut me besnikëri.

Me nderimin që i kushtojmë figurës së **kolonel Imer Selim Hotajt**, përulemi me respekt edhe para kujtimit të të gjithë ushtarakëve që nuk janë më mes nesh, por që mbeten të pranishëm në historinë, traditën dhe kujtesën e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ata i shërbyen Atdheut me besnikëri, sakrificë dhe dinjitet, duke lënë pas një trashëgimi vlerash që frymëzon çdo brez të ri ushtarak.

Shtypi ushtarak ka detyrimin moral dhe institucional të



në ish-Bashkimin Sovjetik. Atje përfaqësoi me dinjitet ushtrinë shqiptare dhe u diplomua me rezultate shumë të mira, duke u kthyer në Shqipëri si një nga specialistët më të përgatitur të kohës.

Më pas, ai kreu edhe një specializim në Kinë, duke thelluar më tej njohuritë e tij profesionale. Pas kthimit në atdhe, u angazhua në Uzinën e Poliçanit, ku dha një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e kapaciteteve teknike dhe industriale të vendit.

Pas rikthimit në atdhe, ai vazhdoi shërbimin në **Forcat Luftarake Detare në Pashaliman**, ku dha një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin teknik të strukturave ushtarake dhe në përgatitjen profesionale të efektivëve. Për kolegët ishte modeli i oficerit korrekt, i drejtë dhe i përkushtuar, ndërsa për vartësit një drejtues që edukonte me shembullin personal.

ruajë të gjallë kujtesën e këtyre burrave e grave të uniformës, të cilët, me punën, karakterin dhe përkushtimin e tyre, kanë shkruar faqe të rëndësishme në historinë e Forcave tona të Armatosura. Emrat e tyre nuk i përkasin vetëm së shkuarës; ata janë pjesë e identitetit, e traditës dhe e vlerave mbi të cilat ndërtohet ushtria shqiptare.

Me respekt e mirënjohje të thellë, gazeta **“Ushtria”** do të vijoje të sjellë në kujtesë jetën dhe veprën e çdo ushtaraku që i shërbeu me nder Atdheut. Sepse një komb që nderon bijtë e tij më të përkushtuar, ruan të paprekura vlerat mbi të cilat ndërton të ardhmen.

Lavdi kujtimit të tyre! Nderim i përhershëm shërbimit dhe sakrificës së tyre në emër të Shqipërisë!

Dr. Rakesh Kumar

[illegible]

Plagët e përgjakura të historisë me masakrat çnjerëzore nuk mbyllen kurrë, por le të lehtësohen dhimbjet dhe kujtesa të jetojë përgjithmonë, që historia të mos përsëritet. Shqiptarët gjatë LANÇ-it me gjakun e tyre shkruan pavdekësinë në altarin e kombit shqiptar, por të ekzekutuarit në luftë jo vetëm që duhet të përkujtohen por edhe të shpallen me titullin e merituar ‘Dëshmorët e Atdheut.’

BE forcon rregullat për metanin: Balancimi mes sigurisë energjetike dhe mbrojtjes së mjedisit

Komisioni European ka publikuar udhëzime të reja për zbatimin e Rregullores së BE-së për Metanin, duke synuar reduktimin e emetimeve të këtij gazi me efekt të fuqishëm serrë, pa rrezikuar sigurinë energjetike të kontinentit. Këto masa vijnë në një kohë kur tregjet globale të energjisë po përballen me pasiguri të mëdha, të nxitura nga konfliktet gjeopolitike në Lindjen e Mesme dhe rritja e çmimeve të naftës e gazit.

Konflikti në Lindjen e Mesme e ka detyruar BE-në të konkurrojë për furnizime në tregjet globale të naftës dhe gazit, të cilat kanë parë një ulje të ndjeshme të furnizimit dhe rritje të çmimeve. Në sfondin e një pasigurie të tillë globale dhe ngushtësie në tregjet e energjisë, Komisioni Evropian po punon me Shtetet Anëtare dhe industrinë për të siguruar që zbatimi i Rregullores së BE-së për të ulur emetimet e metanit në sektorin e energjisë nuk do të dëmtojë në asnjë rrethanë sigurinë e furnizimit të Evropës.

Ndërsa situata e tregut mbetet e paqëndrueshme dhe e pasigurt, Komisioni mbetet i gatshëm të marrë masa të mëtejshme nëse siguria e furnizimit vihet në rrezik në muajt e ardhshëm. Komisioni po monitoron nga afër furnizimet e tregut evropian në bashkëpunim të ngushtë me Shtetet Anëtare.

Për të parashikuar rreziqet e mundshme të identifikuar nga palët e interesuara dhe për të adresuar vështirësitë në zbatimin e rregullave, Komisioni po paraqet dy rekomandime për të udhëzuar vendet e BE-së mbi zgjidhjet e pajtueshmërisë dhe regjimet e ndëshkimeve. Këto rekomandime do të ndihmojnë në krijimin e një kuadri të qartë, të parashikueshëm dhe të besueshëm për zbatimin efektiv të Rregullores së BE-së për Metanin, e cila është një mjet kyç për të zvogëluar emetimet e dëmshme që kontribuojnë në ngrohjen globale, si dhe për të forcuar sigurinë e furnizimit duke adresuar rrjedhjet e metanit.

Rekomandimet e lëshuara sot njohin nevojën për të zvogëluar emetimet e metanit në një mënyrë pragmatike, të efektshme dhe me kosto efektive, për të mbrojtur si mjedisin ashtu edhe sigurinë energjetike. Ato trajtojnë diskutimet me ministrat e energjisë të BE-së në dhjetor 2025 dhe qershor 2026. Ato gjithashtu plotësojnë udhëzimet mbi kërkesat e importit të rregullores së metanit të përditësuara në mars 2026, të cilat sigurojnë që zbatimi të jetë koherent, i qartë dhe i thjeshtë në të gjithë BE-në.

Zgjidhje për pajtueshmëri

Rekomandimi i parë u sjell siguri dhe qartësi importuesve, furnizuesve dhe Shteteve Anëtare të naftës, gazit dhe qymyrit se si të demonstrojnë pajtueshmërinë me detyrimet në Rregulloren që hyn në fuqi më 1 janar 2027 në një mënyrë të thjeshtë. Ai ofron udhëzime mbi zgjidhjet e pajtueshmërisë që importuesit mund të përdorin për të demonstruar prova të pajtueshmërisë tek autoritetet kombëtare, duke përcaktuar kriteret që Shtetet Anëtare duhet të përdorin në vlerësimin e zgjidhjeve. Nuk kërkon gjurmim fizik të molekulave, dërgesave ose ngarkesave specifike.

Në rastin e zinxhirëve më kompleksë të furnizimit, udhëzimi sqaron se importuesit mund të përdorin zgjidhje të tilla si 'gjurmimi dhe kërkesa' dhe 'certifikimi' për të demonstruar pajtueshmërinë. Përdorimi i zgjidhjeve të tilla do ta bëjë demonstrimin e pajtueshmërisë më të lehtë për industrinë pa dobësuar kërkesat.



Ndëshkimet

Shumica e Shteteve Anëtare të BE-së nuk kanë vendosur ende regjime ndëshkuese. Prandaj, kompanitë nuk janë në gjendje të vlerësojnë rreziqet që lidhen me furnizimin me naftë dhe gaz potencialisht jo-përputhës. Kjo krijon pasiguri.

Rekomandimi i dytë jep sqarime mbi pezullimin e masave nga Shtetet Anëtare për mospërputhje për të ruajtur sigurinë e furnizimit.

Rekomandimi sqaron se ndëshkimet, siç kërkohet nga Rregullorja, duhet të mbeten proporcionale dhe nuk duhet të rrezikojnë sigurinë e furnizimit. Ai u rekomandon Shteteve Anëtare të pezullojnë ndëshkimet për mospërputhje për tre vjet (2027 deri në 2029) për të shmangur ndërprerjet e furnizimit. Në të njëjtën kohë, të gjitha detyrimet mbeten në fuqi dhe përputhshmëria është ende e nevojshme.

Duke ofruar siguri ligjore dhe duke inkurajuar një qasje të koordinuar në të gjithë Bashkimin, rekomandimi mbështet Shtetet Anëtare në zbatimin e kërkesave të Rregullores për import pa dëmtuar sigurinë e energjisë. Në këtë mënyrë, udhëzimi gjithashtu ndihmon në sigurimin që Rregullorja e Metanit të mos veprojë, në asnjë mënyrë, si një pengesë për importet.

Rregullorja e BE-së për Metanin, e miratuar në vitin 2024, është legjislacioni i parë gjithëpërfshirës në botë që rregullon gjithashtu emetimet e metanit që lidhen me importet e naftës, gazit dhe qymyrit. Ajo mbulon prodhimin vendas, transportin dhe përpunimin, si dhe importet. Zbatimi i kërkesave të importit është i graduar, me kërkesat e monitorimit të emetimeve që fillojnë, më 1 janar 2027. Ambicia e Rregullores për t'u zbatuar në nivel vendas, së bashku me përpjekjet në nivel ndërkombëtar përmes Premtimit Global për Metanin, e bëjnë BE-në një lider global në reduktimin e metanit.

Inteligjenca artificiale ka hyrë fuqishëm në jetën tonë të përditshme, por ndikimi më i madh i saj po ndjehet në fushën ushtarake. Ajo nuk është më thjesht një mjet ndihmës, por po shndërrohet në një element kyç të strategjive moderne të mbrojtjes dhe sulmit. Ushtritë e botës po investojnë miliarda për të integruar algoritme të avancuara në mjetet e tyre, duke krijuar sisteme që marrin vendime më shpejt, analizojnë më saktë dhe veprojnë me efikasitet të paparë. Ky transformim po sjell një epokë të re, ku fushëbeteja nuk është më vetëm një hapësirë fizike, por edhe një arenë digjitale ku inteligjenca artificiale luan rolin kryesor.

Dronët autonomë si sy dhe duar të reja të ushtrisë

Një nga mjetet më të përhapura janë dronët autonomë. Të pajisur me sisteme të IA, ata janë të aftë të identifikojnë objektiva, të analizojnë terrenin dhe të kryejnë misione pa komandë të drejtpërdrejtë nga operatorët. Kjo u jep ushtrive një avantazh të madh, pasi misionet e rrezikshme mund të kryhen pa rrezikuar jetën e ushtarëve. Dronët nuk janë më thjesht kamera fluturuese, por mjete inteligjente që marrin vendime në kohë reale, duke e bërë luftën më të shpejtë dhe më të sofistikuar.

Lufta elektronike dhe mburoja digjitale

Një tjetër fushë ku AI-ja po bën diferencën është lufta elektronike. Sistemet e reja janë të afta të bllokojnë komunikimet e armikut, të neutralizojnë dronët kundërshtarë dhe të mbrojnë rrjetet e veta. Ato funksionojnë si një mburojë digjitale, duke reaguar menjëherë ndaj çdo ndërhyrjeje. Në këtë mënyrë, IA nuk është vetëm një mjet sulmi, por edhe një mekanizëm mbrojtjeje që siguron stabilitetin e sistemeve ushtarake.

Komanda digjitale dhe oficerët virtualë

Komanda digjitale është një tjetër risi. Algoritmet e IA-së veprojnë si oficerë virtualë, duke shpërndarë detyra, koordinuar operacionet dhe analizuar të dhënat e ardhura nga satelitë, sensorë dhe kamera. Ky rol i ri e shndërron IA-në në një “tru digjital” të ushtrisë, i aftë të përpunojë informacione që një ekip njerëzor do t'i analizonte me ditë të tëra. Vendimmarrja bëhet më e shpejtë, më e saktë dhe më e bazuar në të dhëna të plota.

Mbrojtja kibernetike dhe lufta e padukshme

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është mbrojtja kibernetike. Sulmet digjitale janë bërë një realitet i përditshëm dhe ushtritë nuk mund të mbrohen më vetëm me firewall tradicionalë. IA-ja është në gjendje të zbulojë dhe të neutralizojë sulmet kibernetike në sekonda, duke mësuar nga çdo tentativë e mëparshme. Kjo aftësi e saj për të evoluar e bën një mbrojtës të pazëvendësueshëm në epokën e luftës digjitale.

Dilemat etike dhe rreziqet e autonomisë

Megjithatë, integrimi i IA-së në ushtri nuk është pa rreziqe. Një nga dilemat më të mëdha është autonomia e armëve. A mund të lejohet që një makinë të marrë vendime për jetën dhe vdekjen pa ndërhyrje njerëzore? Ky është një debat i hapur mes ekspertëve të etikës dhe strategëve ushtarakë. Një tjetër shqetësim është siguria e civilëve. Sistemet e automatizuara mund të gabojnë në identifikimin e objektivave, duke shkaktuar viktima të pafajshme. Kjo ngre pyetje të forta mbi përgjegjësinë dhe kontrollin e teknologjisë.

Varësia teknologjike dhe mungesa e ligjit ndërkombëtar

Varësia teknologjike është një tjetër problem. Ushtritë rrezikojnë të bëhen të varura nga kompanitë private që zhvillojnë IA, duke humbur pavarësinë e tyre strategjike. Për më tepër, mungesa e një kornize të qartë ligjore për përdorimin e IA në luftë e bën situatën edhe më të ndërlikuar. Ligji ndërkombëtar nuk është përshtatur ende me realitetin e ri, duke lënë hapësira të mëdha për abuzim.

Pajisje dhe sisteme konkrete me AI në ushtri

1. Project Maven (SHBA)

Një nga projektet më të njohura të Pentagonit, i cili përdor inteligjencën artificiale për të analizuar miliona orë video nga dronët dhe satelitët. Sistemi është i aftë të identifikojë



Mjetet e reja të ushtrisë që mendojnë vetë: Inteligjenca artificiale në fushëbetejë

objektiva ushtarake, të dallojë lëvizjet e armikut dhe të ndihmojë komandantët në vendimmarrje më të shpejtë. Ky projekt ka ngritur debate të forta për rrezikun e gabimeve dhe ndikimin tek civilët.

2. Dronët autonomë Kargu (Turqia)

Turqia ka zhvilluar dronë të vegjël kamikazë të quajtur “Kargu”, të cilët përdorin algoritme të IA-së për të identifikuar objektiva dhe për të kryer sulme pa komandë të drejtpërdrejtë. Ata janë përdorur në konflikte rajonale dhe konsiderohen si shembull i armëve autonome që mund të veprojnë pa ndërhyrje njerëzore.

3. Sistemet Iron Dome me AI (Izrael)

Izraeli ka integruar inteligjencën artificiale në sistemin e tij të mbrojtjes ajrore “Iron Dome”. IA ndihmon në analizimin e trajektoreve të raketave dhe zgjedh objektivat që duhen neutralizuar, duke kursyer municion dhe duke rritur efikasitetin e mbrojtjes.

4. Lufta elektronike me AI (Kina)

Kina ka zhvilluar sisteme të luftës elektronike që përdorin inteligjencën artificiale për të bllokuar komunikimet e armikut dhe për të neutralizuar dronët kundërshtarë në distanca të mëdha. Këto sisteme funksionojnë pa satelitë, duke u bazuar në algoritme të avancuara për koordinim.

5. Robotët ushtarakë për logjistikë (SHBA-të dhe Franca)

Ushtritë po testojnë robotë tokësorë të pajisur me IA për transportin e municioneve, furnizimeve dhe për mbështetje logjistike në terrene të rrezikshme. Këta robotë mund të

lëvizin autonomisht dhe të shmangin pengesat, duke ulur rrezikun për personelin.

Pse janë të rëndësishme këto pajisje?

Shpejtësi dhe efikasitet: IA analizon të dhënat më shpejt se çdo ekip njerëzor.

Reduktim i rrezikut për ushtarët: misionet e rrezikshme kryhen nga mjete pa pilot.

Precizion më i lartë: objektivat identifikohen me saktësi më të madhe. Debat etik: autonomia e armëve ngre pyetje mbi kontrollin dhe përgjegjësinë.

Mes inovacionit dhe humanizmit

Në këtë kontekst, inteligjenca artificiale shihet si një revolucion teknologjik që sjell mundësi të jashtëzakonshme, por edhe përgjegjësi të mëdha. Disa ekspertë e shohin si një mjet që mund të reduktojë viktimat dhe të rrisë efikasitetin e operacioneve, ndërsa të tjerë paralajmërojnë për rrezikun e një lufte të “inteligjentizuar” ku makinat marrin kontrollin. Pyetja kryesore mbetet: a do të jetë inteligjenca artificiale një aleat i njeriut në ruajtjen e paqes, apo një rrezik i ri për njerëzimin? Ushtria e së ardhmes nuk do të bazohet vetëm tek fuqia e armëve tradicionale, por tek inteligjenca e sistemeve digjitale. Sfida e vërtetë është të gjendet balanca mes inovacionit dhe etikës, mes efikasitetit dhe humanizmit. Vetëm kështu mund të sigurohet që ky revolucion teknologjik të shërbejë për mbrojtjen e njerëzimit dhe jo për shkatërrimin e tij.



E ARDHMJAJOTE FILLON KETU!

Nga 27 korriku deri më 1 gusht 2026, bëj zgjedhjen që do të ndryshojë jetën tënde.

Mos zgjidh vetëm një universitet...
Zgjidh një mision.
Zgjidh një profesion.
Zgjidh një të ardhme të sigurt.

AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA / Ku formohen liderët e së nesërme

PROGRAMET E STUDIMIT "BACHELOR"

- Shkenca Ushtarake dhe Lidership
- 4 vite studim
- Marrëdhënie Ndërkombëtare në Fushën e Mbrojtjes
- 4 vite studim
- Teknologji Informacioni dhe Komunikimi në Fushën e Mbrojtjes
- 4 vite studim
- Shkenca Komunikimi në Fushën e Mbrojtjes
- 4 vite studim
- Navigim Detar në Fushën e Mbrojtjes

PSE TË ZGJEDHËSH AKADEMINË E FORCAVE TË ARMATOSURA?
Institucion i akredituar për **5 vite**.

Arsim cilësor me pedagogë dhe personel akademik të kualifikuar në Shqipëri dhe jashtë saj.
Infrastrukturë moderne mësimore dhe stërvitore.
Ushqim dhe akomodim **falas** gjatë studimeve.
Mbështetje financiare gjatë gjithë periudhës së studimit.
Punësim dhe karrierë të garantuar në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, sipas nevojave të tyre.

KJO ËSHTË MË SHUMË SE NJË DIPLOMË

Është një shkollë lidershipi.
Është një profesion me dinjitet.
Është një karrierë në shërbim të vendit.
Është mundësia për të ndërtuar të ardhmen tënde, duke kontribuar në sigurinë dhe mbrojtjen e Shqipërisë.

MOS NDIQ VETËM ËNDRRAT E TUA...
BËHU PJESË E BREZIT QË MBRON ËNDRRAT E NJË KOMBI
AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA
ZGJIDH TË STUDIOSH
ZGJIDH TË UDHËHEQËSH
ZGJIDH T'I SHËRBESH SHQIPËRISË

Aplikimet: **27 korrik – 1 gusht 2026**

MOS NDIQ VETËM ËNDRRAT E TUA...

BËHU PJESË E BREZIT QË MBRON ËNDRRAT E NJË KOMBI
AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA